



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.29/2011
Prishtinë, më 06.09.2011, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Berat Buzhala, Hashim Deshishku, Lutfi Zharku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostić.

Mungoi: Teuta Sahatçija.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi – ZPRK, Haxhi Gashi dhe Kreshnik Kurtish i - USAID/Deloitte, Reshat Fetahu, Gentian Gurra – AKP, Lejla Selimi – OSBE, dhe Natyra Kasumaj - KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Brikena Hoxha, konsulente e Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datave 01 dhe 02. 09. 2011;
3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të Projektligjit nr.04/L-35 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre;
4. Formimi i grupit punues për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-163 për minierat dhe mineralet;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi - Konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Lutfi Zharku - Tha se është kundër rendit të ditës të pika e tretë d.m.th. të shqyrtimi i propozim-amendamenteve të Projektligjit nr.04/L-35 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, sepse kjo pikë e rendit të ditës është votuar në mbledhjen e kaluar të mbajtur më 02.09.2011 dhe nuk është mirë që është kthyer edhe njëherë për shqyrtim.

Visar Ymeri - Kërkoi që rendi i ditës dhe materiali të shpërndahet në përputhje me Rregulloren Kuvendit, d.m.th. katër ditë para mbledhjes.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datave 01 dhe 02.09.2011

Sala Berisha- Shala – Aty ku është "Trepça është nën moratoriumin e Qeverisë", të fshihet emri "e Qeverisë".

Lutfi Zharku - Në vend të amendamentit, të shkruhet që dispozita e këtij Projektligji nuk duhet të trajtohen për zbatim për kompleksin Trepça, sepse duhet të ketë ligj të veçantë për ta rregulluar çështjen e kompleksit Trepça.

Visari Ymeri - Tha se për çështjen e xeheve metalurgjike kam thënë: "Të mos jenë objekte të privatizimit", e jo: "Të mos jetë në kuadër të ndërmarrjes Trepça".

Procesverbalet nga mbledhjet e datave 01 dhe 02.09.2011 me vërejtjet e lartcekura.

3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të Projektligjit nr.04/L-35 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre

Kryetari - Tha se, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës dhe këtij Projektligji, ne e kemi shtyrë disa herë, me propozimin e disa anëtarëve, dhe pastaj në mbledhjen e fundit rezultati ka votimit ishte i barabartë dhe amendamentet nuk u miratuan. Pastaj kam pas kërkesë nga një grup i deputetëve që në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, kanë kërkuar që edhe një herë të sjellë në shqyrtim këtë Projektligj, dhe siç u pa vendimi i Komisionit me shumicë votash, ishte që të shqyrtohet edhe një herë ky Projektligj. Në vazhdim kryetari kërkoi që nëse ka dikush diçka esenciale le të propozojë, në veçanti bëri thirrje për deklaram për ata deputet që kanë munguar në mbledhjen e fundit.

Pas debatit Komisioni me shtatë (7) vota Për dhe tri (3) vota Kundër, nxori këtë

Përfundim

1. Miratohen amendamentet për Projektligjin nr.04/L-35 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, dhe u dërgohen për shqyrtim të mëtutjeshme Komisioneve të përhershme.

2. Autorizohet Njësia mbështetëse e Komisionit që të harmonizojë referencat në mes të amendamenteve dhe të bëjë rregullimin tekniko - gjuhësor në spastrimin e ligjit.

4. Formimi i Grupit punues për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-163 për minierat dhe mineralet

Kryetari – Tha se, siç e dini, ne e kemi pasur një grup punues për monitorimin e Ligjit për miniera dhe minerale, dhe gjatë monitorimit është parë nevoja e ndryshimit dhe plotësimit të ligjit. Kërkoj po nga ai grup punues që të fillojë punën e hartimit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për miniera dhe minerale.

Lutfi Zharku – Tha se kur po flasim për një iniciativë për të ndryshuar një ligj, theksoi se si Komision, nuk e kemi për detyrë ta bëjmë këtë, sepse është Qeveria ajo e cila duhet ta bëjë ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve. Ndërsa, ne si Komision e kemi bërë monitorimin, dhe ne mund t'i rekomandojmë Qeverisë që të merret me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.

Myzejene Selmani - Tha se ne si Komision funksional edhe në mandatin e kaluar, kur kemi shqyrtuar dhe miratuar këtë ligj, kemi hasur në vështirësi të shumta dhe kemi pasur dilema se sa do të gjejë zbatim. Tani gjatë monitorimit, grupi punues ka vërejtur që ka pengesa të mëdha të zbatimit të ligjit për miniera dhe minerale, prandaj është detyrë e Qeverisë që të fillojë plotësimin dhe ndryshimin e ligjit në fjalë.

Sala Berisha – Shala – Tha se ne si grup punues, kemi bërë një punë të mirë gjatë monitorimit të ligjit për miniera dhe minerale, ku gjatë vizitave që kemi pasur nëpër institucione që kanë për obligim për të zbatuar ligjin, po ashtu kemi dalë në terren dhe kemi parë për së afërmi zhvillimet se sa po zbatohet ligji. Andaj duke marrë për bazë problemet e paraqitura nga institucionet përkatëse që kanë të bëjnë me funksionimin e këtij ligji, është paraqitur nevoja për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale. Në fund kërkoi që të formohet një grup punues për ta shikuar mundësinë e fillimit të hartimit të një projektligji.

Visar Ymeri – Tha se grupi punues në raportin e punës për monitorim të ligjit për miniera dhe në rekomandimet e nxjerra në fillim, është paraqitur një rekomandim në fund të raportit që Qeveria të fillojë me ndryshimin dhe plotësimin ligjit, sepse nuk po gjen zbatim të duhur. Ndërsa, pas takimit që kemi pasur me raportuesen, kemi vendosur se pasi që Qeveria ka sjellë plotësim ndryshimin e Strategjisë legjislative për këtë vit, mos t'i rekomandojmë Qeverisë të përfshijë këtë projektligj në Strategji, por të fillojmë ne si Komision që hartojmë ndryshimin dhe plotësimin e ligjit. Por shfaqë brengën se për mungesën e kapaciteteve për hartimin e ligjit për faktin se siç dihet ky ligj mbulon një fushë të gjerë, dhe në fund kërkoi që të presim pas shqyrtimit të raportit për monitorim në seance plenare dhe të shohim se çfarë veprimi të marrim.

Pas debatit, Komisioni njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Kjo çështje të shtyhet dhe të debatohet pas shqyrtimit të Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për miniera dhe minerale në seance plenare.

5. Të ndryshme

a) Dëgjimet publike

Kryetari - Kërkoi nga njësia mbështetëse e Komisionit që aktiviteti që është anuluar lidhur me dëgjimin publik të Projektligjit për tregti me jashtë, të organizohet për javën e ardhshme. Dhe për Projektligjin për hekurudhat e Kosovës, po ashtu të mbahet një dëgjim publik ku të ftohen të gjitha palët e interesit që kanë të bëjnë me këtë Projektligj.

b) Çështjet që kanë të bëjnë me sektorin e energjisë

Kryetari - Propozoi që të ftohen në një mbledhje të Komisionit për çështjen e gjendjes së energjisë elektrike, përfaqësuesit e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Zyrës së Rregullatorit për Energjinë dhe Korporatën Energjetike të Kosovës, për shkak të debateve të fundit në vend.

Ramiz Kelmendi – E përkrahu këtë nismë dhe tha që ka shumë çështje për të diskutuar për vendimin e KEK-ut, ku janë ngarkuar bizneset që të paguhen 25% avancë të energjisë së pashpenzuar. Po ashtu kërkoi që kjo çështje të diskutohet edhe në Kuvend, sepse me këtë vendim të KEK-ut, po dëmtohen shumë bizneset e vendit, dhe është shqetësuese për investorët e jashtëm kjo gjendje e krijuar.

Hashim Deshishku - Po ashtu e përkrahu nismën që të mbahet një takim dhe të diskutohet pse ka ardhur deri të ky vendim i KEK-ut, i cili po dëmton shumë prodhuesit vendorë.

Myzejene Selmani - Propozoi që të bëhet një kërkesë nga ana e Komisionit, për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik që të anulohet ky vendim, sepse KEK-u është kompani publike dhe i përgjigjet Qeverisë, dhe mbështetet financiarisht çdo vit edhe nga buxheti i Kosovës.

Visar Ymeri – Propozoi që së pari të ftohen institucionet relevante dhe të gjitha palët tjera dhe pastaj të mbledhemi si Komision dhe të nxjerrim rekomandimet e duhura.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

Përfundim

Të ftohen në një seance dëgjimore në Komision, përfaqësuesit e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Zyrës së Rregullatorit të energjisë, Korporatës Energjetike të Kosovës, Odës Ekonomike të Kosovës, për të diskutuar për sektorin e energjisë elektrike.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

Përgatiti:

Kryetari i Komisionit

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti